

KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL
GUSHT 2022



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM	12

HYRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2022.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji gusht i vitit 2022, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve të kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin gusht, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

Rahoveci është renditur Komuna më transparente në Republikën e Kosovës, për periudhën janar – qershor 2022, nga “Aleanca Qytetare për Transparencë”, e përbërë nga Instituti Dekokratik i Kosovës (KDI), ULOF PALME INTERNATIONAL CENTER - KOSOVO PROGRAM si dhe 9 organizatat e tjera partnere. Bazuar në vlerësimin e bërë për 38 komunat e Republikës së Kosovës, Rahoveci për gashtëmujorin e parë të këtij viti ka arritur nivelin më të lartë në përmbyshjen e indikatorëve vlerësues me 83 pikë apo 94.32%.

PËR 38 KOMUNAT E KOSOVËS

Krahosimi i transparencës së komunave Janar – Qershor 2021/2022

Komuna	2021	2022	2021	2022	Progresi / Ndryshimi
Pikë	Pikë	Pikë	Pikë		
1. Rahoveci	83	83	83	83	
2. Gjakovë	80	80	77	77	
3. Kamenitë	78	78	67	70.49	
4. Malishevë	78	78	83	82.98	
5. Lipjan	77	77	81	81	
6. Prizren	77	77	79	79	
7. Prishtinë	77	77	67	76.54	
8. Prishtinë	77	77	73	82.98	
9. Drenas	76	76	78	78	
10. Prizren	76	76	69	78.63	
11. Prizren	76	76	68	77.77	
12. Shtetë	73	73	71	80.48	
13. Ferizaj	71	71	78	78.65	
14. Malishevë	71	71	71	80.68	
15. Tetovë	71	71	67	70.49	
16. Gjakovë	69	69	68	68.18	
17. Gjakovë	69	69	66	75	
18. Mamë e Bishë	68	68	74	86.99	
19. Shkup	68	68	75	75	
20. Drenas	67	67	87	84.14	
21. Viti	66	66	67	76.14	
22. Shkup	66	66	63	68.64	
23. Kladovë	63	63	69	78.67	
24. Vushtri	63	63	68	77.77	
25. Jash	60	60	65	66.5	
26. Mamë e Bishë	60	60	65	66.5	
27. Shtetë	60	60	65	66.5	
28. Drenas	60	60	64	72.73	
29. Drenas	60	60	64	66.67	
30. Lipjan	60	60	60	66.67	
31. Malishevë	60	60	60	66.67	
32. Drenas	60	60	60	66.67	
33. Kladovë	60	60	60	66.67	
34. Prizren	60	60	60	66.67	
35. Novo Brdo	60	60	37	61.54	
36. Prizren	60	60	36	60	
37. Prizren	60	60	49	81.68	
38. Zupë	60	60	37	61.54	



Në shtëpinë e kulturës “Mensur Zyberaj” në Rahovec, në prani të familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe miqve, u shënuar në mënyrë të veçantë 50-vjetori i lindjes së dëshmorit Skender Gashi, ku autori Qemajl Krasniqi ka bërë promovimin e monografisë “Deri në frymën e fundit”.

Kjo monografi përmbledh dëshmi e fakte për njeriun që mundin, djersën, gjakun dhe jetën ia kushtoi çlirimit dhe bashkimit të atdheut.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të aktivitetit "Ditët e Mërgatës", në Krushë të Madhe ka organizuar "Sofrën e Mërgimtarit", ku morën pjesë bashkatdhetarët tanë nga vende të ndryshme.



Kryetari Latifi ka mbajtur një takim këshillues me z. Agron Sokoli, Kryesues i Këshillit Organizues të Festës së Vjeljes së Rrushit (HARDHFEST) në Rahovec, ku me datat 2, 3 dhe 4 shtator, bashkërisht do të përjetojmë rikthimin e fuqishëm të "HARDHFEST" - it, plot befasi e begati dhe aktivitete.

Në prani të z. Ylber Çitaku, Zv. Drejtor i Departamentit për Zhvillim Rajonal në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe z. Kreshnik Basha, Menaxher i Programit të organizatës së Caritasit Zviceran (CaCH) së bashku me drejtorin e arsimit, kryetari Latifi ka nënshkruar dy marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi për komunën tonë. Marrëveshja e parë e bashkëpunimit ka të bëjë me fillimin e zbatimit të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis"(YENI). Për secilin projekt nga 3 shkollat, Caritasi Zviceran do të sigurojë 90% të mjeteve financiare, ndërsa Komuna e Rahovecit, përkatësisht DKA do të sigurojë 10%. Vlera e përgjithshme e secilit projekt është 4400 €, ndërsa për të 3 Shkollat e Mesme të Larta, vlera është 13.200 €.



Marrëveshja e dytë e bashkëpunimit ka të bëjë me fillimin e zbatimit të projektit "Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë" (MARDI).

Në prani të familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe miqve, është mbajtur mbledhja komemorative, me rastin e ndarjes nga jeta të bashkëluftëtarit, bashkëpunëtorit dhe Kryetarit të OVL të UÇK-së në Rahovec, Vajdin Berisha.



Në kuadër të aktivitetit "Ditët e Mërgatës" është bërë promovimi i librit "100 Kultivar Hardhie" nga autori Rexhep Kryeziu.

Së bashku me drejtorin Berat Duraku si dhe me zyrtarët e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kryetari Smajl Latifi ka bërë shpërndarjen e pajisjeve bujqësore për 38 bujq përfitues. Mekanizmat që janë ndarë në këtë fazë janë: 27 motokultivatorë me frezë 7.5 KW, 3 spërkatëse 500 L, 8 rrotokosa dhe 1 mbledhëse e barit (grabujë).



Në kuadër të aktivitetit “Ditët e Mërgatës”, për nder të bashkatdhetarëve tanë, u organizua koncerti i radhës në Ratkoc, ku performoi grupi i njohur “04 BAND”.



Kryetari Latifi së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike Përparim Krasniqi, në prani të qytetarëve është përfuruar ndriqimin publik në Brestoc dhe Hoçë të Vogël, në gjatësi prej 3.4 kilometra në rrugën kryesore që lidh dy fshatrat.

Komuna e Rahovecit me mbështetje të CARITAS Switzerland & GERMIN, përmes projektit “Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë - MARDI”, ka organizuar për herë të parë në formatin B2B takim me rreth 30 biznese të Diasporës dhe ato vendore në Rahovec, me qëllim të rrjetëzimit dhe krijimit të partneriteteve të reja. Bizneset u njoftuan më shumë për veprimtarinë e njëra-tjetrës dhe mundësinë e investimit në Kosovë, eksportit jashtë vendit dhe rreth praktikave më të mira të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale dhe bizneseve.



Nën organizimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Komuna e Rahovecit mbajti dëgjimin publik buxhetor me organizatat joqeveritare që veprojnë në komunën e Rahovecit, ku janë parashtruar kërkesat e tyre.



Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me stafin e tij, kanë vizituar punimet që po zhvillohen te kanali i kullimit të tokave bujqësore në Rahovec dhe Fortesë, me gjatësi prej 5 km.

Është mbyllur me sukses aktiviteti “Ditët e Mërgatës”, të cilët kanë filluar nga 15 korriku e deri me 15 gusht. Në këtë periudhë janë organizuar shumë aktivitete si: turneu ndërkombëtar i shahut, mbrëmjet muzikore, turnir në futboll, pritja e mërgimtarëve nga kryetari.



Kryetari Latifi ka pritur në takim drejtorin e distriktit të KEDS-sit në Gjakovë z. Kreshnik Sokoli me bashkëpunëtorë, ku kanë diskutuar për problemin e furnizimit të rregullt me energji në Stacionin-I të Rahovecit, të pompave të ujit për pije, që do të mundësojë furnizim të rregullt me ujë në pjesën e qytetit.

Po ashtu, biseduan edhe për çështje të tjera që lidhen me bashkëpunimin për investimet dhe lehtësirat që do t'i aplikojë KEDS-i në koordinim me komunën e Rahovecit.



Angazhimet për mirëmbajtjen e hapësirave publike kanë vazhduar në: varreza civile, lapidare dhe vendrëniet e dëshmorëve, varreza të dëshmorëve, mjediset përreth objekteve të gjendjes civile dhe të QMF dhe AMF në fshatrat Xërxë, Krushë e Madhe, Drenoc, Pastasel, Opterushë, Zoqisht, Retijë, Retijë e Ulët dhe Brestoc.



Kryetari Smajl Latifi së bashku me bashkëpunëtorë morën pjesë në përfundimin e fillimit të projektit: "Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit". Projekti bashkëfinancohet nga Komuna e Rahovecit dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe kap vlerën: 155,959.00 €, ku komuna e Rahovecit merr pjesë me 80,959.00€, ndërsa MZHR me 75,000.00€. Projekti parasheh, platonë me fontanë të rrafshët, ulëse, ndriçim të ulët, drunj dekorues dhe elemente të tjera përcjellëse që do t'i japin pamje të bukur dhe funksionale qendrës së qytetit.

Kryetari Latifi priti në zyrën e tij dy nga trembëdhjetë të mbijetuarit e Masakrës së 31 marsit në Pastasel, Tahir Krasniqin dhe Beqir Krasniqin, me ç'rast në shenjë respekti për gjithë atë çka këta përjetuan, kryetari ka ndarë mirënjohje me motivacion: "Për mundin, sakrificën dhe dëshmitë e luftës paraqitur edhe para Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve të Luftës në Hagë, për zbardhjen e krimeve serbe".



Kryetari Smajl Latifi së bashku me stafin e tij kanë përfunduar ndriçimin publik në segmentin e unazës në qytet prej 650 metra (30 drita), si pjesë e projektit të ndërtimit të rrugës Rahovec - Hamoc - Fortesë. Ky segment rrugor, përveç sigurisë, krijon edhe qasje të mirë për të gjithë qytetarët që lëvizin gjatë mbrëmjes dhe e shfrytëzojnë këtë rrugë në formë shtegu. Përfundimi i ndriçimit publik i cili lidh rrugën "Mexhit Mustafa" e të shpie kah Veraria "Kosova Wine" dhe lidhet me rrugën "Vëllezërit Haradinaj".

Kryetari Latifi së bashku me stafin e tij e në prani të familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe qytetarëve nga Malësia e Vogël dhe Vrajska, ka bërë homazhe në përvjetorin e rënies së dëshmorëve të kombit Skender Kastrati dhe Sabri Morina, të cilët ranë për të mos vdekur kurrë, më 26 gusht 1998.




Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Afrim Dina, së bashku me bashkëpunëtorët e tij ka përcjellur nga afër punimet në infrastrukturën e terreneve sportive, ku kanë përfunduar punimet në asfaltimin e fushave sportive në fshatrat Retijë e Poshtme dhe Celinë.




Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal u mbajt konsultimi publik për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave 2021-2024.

Takimin e kryesoi Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, z. Përparim Krasniqi, i cili para pjesëmarrësve në konsultim prezantoi në pika të shkurtra Planin e Menaxhimit të Mbeturinave për komunën e Rahovecit, objektivat, strategjinë e procesit të hartimit dhe implementimit të tij.

Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, dje është mbajtur mbledhja e pestë e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB). Sa i përket vlerësimit të përgjithshëm të gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, kryetari Latifi është shprehur se situata në gjithë territorin e komunës është e qetë dhe stabile, duke u bazuar në raportet policore si dhe institucionet relevante.





Kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit, Defrim Kafexhiu, është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit.

Në rend dite ishin këto pika:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021,
- Vendimi për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit,
- Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec,

- Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec,
- Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec,
- Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol,
- Vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol,
- Vendimi për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës,
- Vendimi për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.339/22, i datës: 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Në Ditën Ndërkombëtare të të zhdukurve me dhunë, kryetari Latifi së bashku me stafin e tij, kujtuan dhe nderuan njerëzit tanë, që edhe pas 23 vjetësh ende janë të pagjetur. Kjo plagë mbetet sfida dhe obligimi moral më i madh institucional si dhe ndërkombëtar që nga paslufta.

Në ditën kur bota kujton personat e zhdukur, Komuna e Rahovecit kujton 103 të pagjetur, ku 64 të pagjetur janë vetëm në Krushë të Madhe, pa harruar edhe profesorin dhe politologun e shquar, Ukshin Hoti.





Kryetari Smajl Latifi së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka mbajtur takim me Këshillin Organizativ të festivalit "Hardh Fest". Festivali që i kushtohet Festës së Vjeljes së Rrushit në komunën tonë, është kthyer pas dy viteve ndërprerje për shkak të krizës nga pandemia.

Festivali "Hardh Fest" është bërë një prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore në Kosovë, rajon dhe po depërton e njihet edhe në Evropë e më larg, duke promovuar vreshtarinë dhe kulturat tjera bujqësore, por dhe punën e palodhshme e fisnike të bujqve rahovecianë, drejtuesve dhe organizatorëve të festivalit.

PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit gusht 2022.

Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit.

Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini mujor ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, gusht 2022